



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr.2004/46

PER LIBRAT AMZE

Kuvendi i Kosovës

Në pajtim me autoritetin ligjvënës që i është dhënë Kuvendit të Kosovës në Kreun 9.1.1 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2001/9 të Kornizës Kushtetuese;

Duke pasur parasyshë Kreun 5.1 pika (i) dhe 9.1.26 të Rregullorës së UNMIK-ut nr. 2001/9 të Kornizës Kushtetuese;

Me qëllim të krijimit të kushteve, formave dhe të një procedure koherente për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile të qytetarëve të Kosovës;

Miraton:

LIGJIN PER LIBRAT AMZE

Kreu I

Dispozitat e përgjithshme
Neni 1

Me këtë ligj rregullohen dhe përcaktohen: librat amzë, mënyra e mbajtjes dhe e ruajtjes, llojet e librave amzë, mënyra dhe faktet e regjistrimit, regjistrimet e mëvonshme, vërejtjet, ruajtja, ripërtirja, bashkëpunimi dhe mbikëqyrja rreth udhëheqjes së librave amzë.

Përkufizimet
Neni 2

“**Librat Amzë**” janë libra zyrtarë ku mbahen shënimet lidhur me gjendjen personale të qytetareve lidhur me faktet e të gjitha: lindjeve, martesave dhe vdekjeve dhe të dhënave tjera që burojnë prej tyre.

“**Libër Amzë i të Lindurëve**” është libri ku mbahen shënime lidhur me faktet e të gjithë të lindurve në Territorin Amë apo komunën ku ka ndodhur lindja.

“**Libër Amzë i martesave**” është libri ku mbahen shënimet lidhur me faktet e të gjitha martesave në komunën përkatëse.

“**Libër Amzë i të Vdekurve**” është libri ku mbahen të gjitha shënimet lidhur me faktet e të gjitha vdekjeve të ndodhura .

“**Territori Amë**” është vendi të cilin e përbëjnë të gjitha lokalitetet e banuara për të cilat mbahen Librat e Amzës.

“**Zyra e Gjendjes Civile**” është Zyra e Gjendjes Civile në Territorin Amë apo në komunën përkatëse ku regjistrohen faktet e lindjeve, martesave dhe vdekjeve.

“**Ngjyra speciale e zezë**” është ngjyrë e veçantë dhe e vetme e lejuar që përdoret për të shënuar të dhënat në librat amzë.

“**Rubrika regjistrime të mëvonshme**” është rubrikë e veçantë në librin amzë ku bëhen shënime në regjistrimet e mëvonshme lidhur me faktet që regjistrohen.

“**Rubrika vërejtje**” është rubrikë në të cilën shënohen të dhënat plotësuese.

“**Çertifikatë**” është dokument zyrtar që e lëshon Zyra e Gjendjes Civile si dëshmi e të dhënave të bazuara në librat amzë

Librat Amzë Neni 3

3.1. Librat Amzë janë libra në të cilat mbahen shënimet-evidencat themelore zyrtare mbi gjendjen civile të qytetarëve.

3.2. Në librat amzë regjistrohen faktet e: lindjes, martesës, vdekjes dhe ndryshimet që kanë të bëjnë lidhur me këto fakte të qytetarëve në Kosovë dhe regjistrimi i këtyre fakteve të ndodhura jashtë vendit .

3.3. Faktet dhe të dhënat e lidhura me lindjet, martesat dhe vdekjet e qytetarëve të Kosovës që kanë ndodhur jashtë territorit të Kosovës duhet të regjistrohen vetëm në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile të cilës i takon pala.

3.4 Librat amzë mbahen në dy mënyra: në formë të shkruar dhe në ato elektronike.

3.5. Forma elektronike mbahet sipas udhëzimeve të Ministrisë përkatëse.

Mirëmbajtja e librave amzë Neni 4

4.1. Librin amzë e mban dhe udhëheq drejtëpërdrejtë zyrtari i autorizuar përkatësisht i certifikuar për kryerjen e punëve të gjendjes civile- Zyrtari i Zyrës të Gjendjes Civile (në tekstin e mëtejme - ZGjC) në komunë përkatësisht i Zyrës Administrative në Territorin Amë për regjistrimin e fakteve të gjendjes civile.

4.2. Zyrtari i gjendjes civile kur mungon zëvendësohet nga zyrtari tjetër i ZGjC i caktuar për zëvendësim me të gjitha autorizimet e tij.

4.3. Territorin amë, numrin dhe vendbanimet që përfshinë ky territor i cakton Kuvendi Komunal.

4.4. Në territorin amë mbahen libri amzë i të lindurve dhe i të vdekurve kurse libri i përbashkët amzë i të martuarve mbahet vetëm në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile në Komunë.

- 4.5. Për secilin vit kalendarik mbahen libra të veçanta.
- 4.6. Nëse gjatë vitit kalendarik libri amzë plotësohet atëherë regjistrimi vazhdon në librin tjetër të amzës me numrin pasues nga libri i mëparshëm.
- 4.7. Librat amzë përfundohen në fund të çdo viti duke shënuar “përfundon me numrat vijues (shënohet me numra dhe me germa numri i regjistrimeve) të regjistrimeve në atë vit”.
- 4.8. Nëse gjatë vitit kalendarik nuk ka pasur fakte të regjistrimit të lindjeve, martesave ose vdekjeve, në këtë libër për vitin përkatës shënohet “për këtë vit nuk ka pasur regjistrime”
- 4.9. Në vitin pasues kalendarik regjistrimi i parë fillon me numrin 01.
- 4.10. Regjistrimet në librin amzë bëhen sipas radhës së paraqitjeve të rasteve për regjistrim.
- 4.11. Në librin amzë në të cilin regjistrimi i fundit është kryer para 110 viteve ato libra dërgohen në Arkivin e Kosovës.
- 4.12. Llojin dhe lartësinë e taksës për shërbime administrative për regjistrimin e fakteve e cakton kuvendi komunal në suaza të përcaktuara me ligj.

Shënimet paraprake në librat amzë Neni 5

- 5.1. Në librin amzë në faqën e parë në të cilin nuk ka numër të shënuar vëhet:
 - a. Emri i librit të amzës (p.sh. libri amzë i të lindurve, libri amzë i të martuarve ose libri amzë i të vdekurve),
 - b. Emri i vendit në të cilin mbahet libri amzë dhe emri i komunës,
 - c. Data e regjistrimit të parë dhe të fundit të regjistrimit,
 - d. Shenja e vulës,
 - e. Nënshkrimi i zyrtarit të gjendjes civile,
 - f. Nënshkrimi i Kryetarit të Kuvendit Komunal dhe
 - g. Vërtetimi i numrit të faqeve të librit amzë.
- 5.2. Nëse ndryshon emri i vendit respektivisht i territorit amë apo komunës ku mbahen librat amzë , ndryshimet e tilla shënohen në vazhdim të thirrjeve të mëparshme.

Mënyra e regjistrimit Neni 6

- Rastet e faktit të lindjes, martesës dhe vdekjes shënohen në atë mënyrë që:
- a. dita shkruhet me numra arab , kurse në kllapa me shkronja
 - b. muaji shkruhet me shkronja
 - c. viti me numra arab kurse
 - d. orët me numra prej 00-24 dhe minutat prej 00-60

Neni 7

Mbikëqyrjen, kontrollimin, mënyrën e mbajtjes , ruajtjen elektronike, shpërndarjen e librave amzë dhe përcjalljen e regjistrave përcjellës abcd dhe certifikatave, shpërndarjen e vulave, përcaktimin e zyrtarëve të autorizuar për nënshkrim caktimin e mënyrës së udhëheqjes së librave amzë rreth punëve të gjendjes civile e bënë Ministria përkatëse.

Neni 8

8.1. Në librin amzë shkruhet vetëm me ngjyrën e zezë speciale e cila shërben për të shënuar të dhënat me shkrim lidhur me faktin që kërkohet të regjistrohet.

8.2. Në librin amzë nuk lejohet të shënohen të dhëna të tjera pos atyre që kanë të bëjnë me faktet e shkruara që i janë paraqitur respektivisht ato shënime që i mbanë akti i organit kompetent.

8.3. Shënimet që regjistrohen në librin amzë detyrimisht duhet të jenë të vërteta.

8.4. Për shënimin e emrit personal dhe mbiemrit, përdoret gjuha e kërkuesit për të shënuar të dhënat sipas rregullave drejtëshkrimore të gjuhës (me alfabet latin) të kërkuesit.

Gabimet dhe përmirësimet e tyre

Neni 9

9.1. Nëse Zyrtari i Gjendjes Civile vëren se janë bërë gabime gjatë regjistrimit para se të përfundoj regjistrimi, ato gabime mund t'i përmirësoj ai vetë.

9.2. Përmirësimin e tillë Zyrtari i Gjendjes Civile është i detyruar që ta konstatoj dhe vërtetoj në librin amzë me nënshkrimin e vet dhe me vulë në rubrikën “vërejtje”.

9.3. Përmirësimet e mëvonshme në librin amzë mund të bëhen vetëm me aktvendim të organit kompetent duke e regjistruar këtë ndryshim në rubrikën “shënime pas regjistrimit të përfunduar” duke shënuar:

- a. Çka është përmirësuar
- b. Organin që ka nxjerrë aktvendim
- c. Numrin dhe datën e aktvendimit.

9.4. Për çdo përmirësim të mëvonshëm në librin burimor të amzës të përfunduar, Zyrtari i Gjendjes Civile ka për detyrë që në afat prej 3 ditësh pas kryerjes së këtij përmirësimi t'a njoftoj organin kompetent që ruan kopjen përkatëse të librit amzë, në mënyrë që ky përmirësim të evidentohet dhe të bëhet edhe në kopjen e tillë nga ky organ.

9.5. Nën çdo shënim “regjistrimet e mëvonshme dhe shënimet” vëhet:

- a. Data e shënimit (në anën e majtë) dhe
- b. Nënshkrimi i zyrtarit të gjendjes civile (në anën e djathtë)

9.6. Nëse rubrikat “vërejtje“ dhe “regjistrimet e mëvonshme” janë plotësuar kurse regjistrimi nuk është kryer ose është e nevojshme të evidentohen shënime të reja, posa të bëhet regjistrimi plotësues, ky shënim vazhdohet në rubrikat përkatëse me një fletë të veçantë “fletëplotësuese”

9.7. Në këtë fletë shënohet:

- a. Numri vijues i regjistrimit themelor dhe
- b. Fleta vërtetohet me vulën e organit kompetent ashtu që shenja e vulës të përfshijë faqen e librit amzë.

9.8. Nëse gjatë regjistrimit të bërë janë shënuar gabimisht të dhënat në disa rubrika ashtu që përmirësimi nuk mund të zbatohet Zyrtari i Gjendjes Civile do të bëjë regjistrimin e drejtë në formularin vijues me numrin e njëjtë vijues e në mënyrë diagonale do t'i bjerë vizë formularit të plotësuar gabimisht e pastaj e bënë shënimin në rubrikën “vërejtje” me shenjen se regjistrimi i rregullt është bërë në formularin vijues.

9.9. Kur përmirësimi i regjistrimit bëhet sipas paragrafit 9.8 të këtij neni bëhet sipas aktvendimit të organit kompetent Zyrtari i Gjendjes Civile do të bëjë regjistrimin e rregullt nën numrin e ri vijues i cili pason pas regjistrimit të fundit të bërë, e pastaj me vizë diagonale do të anulohet formularin e plotësuar gabimisht dhe në rubrikën “ regjistrime të mëvonshme” do të shënoj “është përmirësuar në bazë të aktvendimit të organit kompetent: datën, numrin e aktvendimit dhe regjistrimi është bërë në numrin vijues”

9.10. Kur regjistrimi themelorë është bërë gabimisht në librin tjetër (regjistrimi i bërë sipas kompetencës) Zyrtari i Gjendjes Civile, zyrtari ose personi tjetër që ka vërejtur gabimin e informon menjëherë organin kompetent komunal për këtë.

9.11. Pas vendimit të organit kompetent për përmirësim, Zyrtari i Gjendjes Civile do të anulohet regjistrimin e bërë gabimisht me vijë diagonale dhe në rubrikën “regjistrimet e mëvonshme” saktëson se:

- a. Regjistrimi i bërë gabimisht anulohet në bazë të aktvendimit përkatës për këtë regjistrim ,
- b. duke cekur organin që ka lëshuar aktvendimin,
- c. numrin, dhe datën e aktvendimit
- d. se regjistrimi është bërë në librin përkatës të amzës (sipas faktit)
- e. vendin e banimit dhe komunën dhe
- f. numrin vijues

Nënshkrimi i regjistrimit

Neni 10

10.1. Zyrtari i Gjendjes Civile pas përfundimit të regjistrimit duhet t'i lexoj personit që ka paraqitur faktin respektivisht dëshmitarëve të gjitha shënimet e regjistruara dhe këtë do ta vërtetoj në librin amzë në rubrikën e vërejtjeve.

10.2. Regjistrimin në librin e amzës e nënshkruan personi që ka paraqitur faktin për regjistrim, dëshmitarët dhe Zyrtari i Gjendjes Civile.

10.3. Nëse personi që ka paraqitur faktin për regjistrim apo dëshmitarët refuzojnë të nënshkruajnë regjistrimin, Zyrtari i Gjendjes Civile këtë do ta konstatoj në librin e amzës dhe për këtë përpilon një shënim.

Kopjet e librave amzë

Neni 11

- 11.1. Përpos librave burimor të amzës mbahen edhe kopjet e tyre perkatëse në formën e njëjtë sikur të librit burimor.
- 11.2. Kopjet e librave burimore plotësohen paralelisht me librin burimor dhe detyrimisht duhet të përmbajnë të gjitha shënimet që përmbanë libri burimor.
- 11.3. Për dallim nga librat burimore, kopjet e tyre i mban dhe ruan organi kompetent.
- 11.4. Kopjet e librave burimore mund të fotokopjohen dhe fotokopja e tillë paraqet „kopjen e dytë” dhe vërtetohet nga organi kompetent pas barazimit me kopjen e parë.
- 11.5. Nëse humbet ose asgjësohet libri burimor i amzës organi kompetent që ruan kopjen e parë apo të dytë lëshon certifikata në bazë të këtyre kopjeve deri në kohën e përshkrimit të librit burimor.
- 11.6. Kopjet elektronike të librave amzë i mban dhe ruan organi kompetent qëndror i gjendjes civile në Ministrinë përkatëse.

Ruajtja e librave amzë

Neni 12

- 12.1. Librat amzë të përfunduara gjatë vitit kalendarik vërtetohen vulosën dhe nënshkruhen nga zyrtari i autorizuar i gjendjes civile në fund të vitit.
- 12.2. Librin burimor të amzës e ruan Zyrtari i Gjendjes Civile, kurse kopjen e librit të amzës e ruan organi kompetent.
- 12.3. Librat e amzës patjetër ruhen duke siguruar në masë më të madhe sigurinë e tyre nga dëmtimet apo asgjësimi i tyre,
- 12.4. Librat amzë burimore si dhe kopjet e tyre nuk guxojnë të ruhen në të njëjtën ndërtesë.

Regjistri i librave të amzës

Neni 13

- 13.1. Krahas çdo libri të amzës mbahet edhe regjistri i shënimeve abcd-ve
- 13.2. Ky regjistër mbahet sipas formularit përkatës.
- 13.3. Lidhur me formularin e regjistrimit organi kompetent nxjerrë akte rregullative për përmbajtjen dhe formën e formularit.
- 13.4. Regjistri mbahet sipas germës së parë të mbiemrit ndërsa për kufomat e pidentifikuara përdoret shkronja “N”
- 13.5. Së bashku me regjistrin e librave amzë për interes të efikasitetit mund të mbahet edhe kartoteka.

E drejta e shikimit të shënimeve në librat amzë
Neni 14

Të drejtën e shikimit në librat e amzës e ka:

- a. personi i interesuar për të cilin mbahen shënimet,
- b. anëtari i familjes së tij të ngushtë,
- c. adoptuesi apo kujdestari ose përfaqësuesit e tjerë të autorizuar ,
- d. personi tjetër zyrtar vetëm me arsyen e interesit të përgjithshëm dhe të bazuar në ligj.

Kreu II

Llojet e Librave Amzë
Neni 15

15.1. Për secilin fakt të gjendjes civile të qytetarëve mbahet libër i veçantë si: libri amzë i të lindurëve, libri amzë i martesës dhe libri amzë i të vdekurve.

15.2. Krahas me librat amzë mbahet edhe regjistri abcd-ve

Libri Amzë i të lindurve
Neni 16

16.1. Në librin amzë të të lindurve regjistrohet fakti i lindjes së fëmiut.

16.2. Fakti i lindjes regjistrohet në territorin amë respektivisht në Zyrën Komunale të Gjendjes Civile në komunën ku ka ndodhur lindja.

16.3. Fakti i lindjes paraqitet me shkrim nga organi kompetent (institucioni shëndetësor) ku ka ndodhur lindja brenda afatit prej 15 ditëve.

16.4. Fakti i lindjes regjistrohet në librin amë brenda 30 ditëve nga dita e lindjes.

16.5. Lindjen e fëmiut jashtë institucionit shëndetësor brenda afatit prej 30 ditësh ka për detyrë që ta paraqes:

- a. I ati respektivisht e ëma e fëmiut,
- b. Personi në shtëpinë (banesën) e të cilit ka ndodhur lindja,
- c. Mjeku, mamia apo personi tjetër nëse kanë marrë pjesë me rastin e lindjes.

16.6. Në rastet kur lindja nuk paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh të parapar në paragrafin 7 atëher regjistrimi bëhet me aktvendim të organit kompetent mbi regjistrimin e mëvonshëm

16.7. Faktin e lindjes ka për detyrë ta paraqes edhe personi që ka gjetur fëmiun dhe Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “vërejtje” shënon të gjitha të dhënat rreth rastit të gjetjes së fëmiut dhe të dhënat e personit që ka gjetur fëmiun.

16.8. Në regjistrimin e faktit të lindjes si shënime bazë shënohet:

- a. Emri dhe mbiemri i fëmiut
- b. Gjinia e fëmiut

- c. Dita muaji ora dhe vendi i lindjes
- d. Numri personal
- e. Emri dhe mbiemri i prindërve (për prindin që ka ndryshuar mbiemrin pas martesës shënohet edhe ai mbiemër p.sh mbiemri i vajzërisë për nënën)
- f. Data e lindjes së prindërve dhe vendi i lindjes
- g. Vendbanimi dhe adresa e prindërve
- h. shtetësia

16.9.Si shënime plotësuese shënohen këto të dhëna:

- a. emri personal i fëmiut
- b. pranimi apo vërtetimi i atësisë përkatësisht amësisë
- c. lidhja e martesës së prindërve nëse kjo martesë bëhet pas lindjes së fëmiut.
- d. Kujdestari i fëmiut
- e. Heqja apo kthimi të drejtave prindore mbi fëmiun,
- f. Vazhdimi apo ndërprerja e të drejtave prindore,
- g. Lidhja apo shkëputja e martesës,
- h. Ndërrimi i emrit apo mbiemrit të fëmiut, prindërve, kujdestarit apo adoptuesit,
- i. Ndërrimi i shtetësisë,
- j. Vdekja apo shpallja për të vdekur i personit të zhdukur dhe
- k. Përmirësimet e kryera pas regjistrimit bazë.

16.10. Zyrtari i Gjendjes Civile lidhur me faktin e lindjes së paraqitur përpilon procesverbal.

16.11. Nëse faktin e lindjes e paraqet institucioni shëndetësor, kjo shënohet në rubrikën “vërejtje”

16.12.Nëse fakti i lindjes regjistrohet në bazë të aktvendimit të organit kompetent komunal kjo shënohet në rubrikën “vërejtje”

Caktimi, korigjimi, ndërrimi dhe përmirësimi i emrit personal Neni 17

Caktimi, ndryshimi, ndërrimi dhe përmirësimet e emrit personal rregullohet me ligjin për emrin personal.

Regjistrimi i faktit të lindjes në rast të mungesës së njërit apo të dy prindërve Neni 18

18.1. Me rastin e regjistrimit të faktit të lindjes kur njëri prind është i pa njohur rubrika në librin amzë për të dhënat e atij prindi nuk plotësohet por shënohet se prindi është i panjohur.

18.2. Kur janë të dy prindrit të panjohur regjistrimi bëhet në bazë të aktvendimit të organit të kujdestarisë kurse në rubrikën „vërejtje“ apo „regjistrime të mëvonshme“ duke shënuar:

- a. Se regjistrimi është bërë me aktvendimin e organit të kujdestarisë
- b. Emri i organit të kujdestarisë
- c. Numri dhe data e aktvendimit

18.3. Kur me vendim të gjyqit është përcaktuar prindi Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën „vërejtje“ ose „regjistrimet e mëvonshme“ shënon:

- a. Babai/nëna e fëmiut është përcaktuar me vendim të gjyqit
- b. Emri i gjyqit dhe selia
- c. Numri dhe data e vendimit

18.4. Me rastin e gjetjes së fëmiut të posalindur prindërit e të cilit nuk dihen Zyrtari i Gjendjes Civile menjëher përpilon procesverbal.

18.5. Procesverbali përpilohet në tre ekzemplar dhe përmban:

- a. Emrin, mbiemrin dhe adresën e personit që ka gjetur fëmiut apo ka paraqitur gjetjen e fëmiut
- b. Vendin dhe kohën e gjetjes
- c. Rrethanat në të cilat është gjetur fëmiu
- d. Moshja e sakt dhe gjinia e fëmiut
- e. Shenjat dalluese apo të veqanta trupore të fëmiut
- f. Thirrjen e entit apo të dhënat e personit ku gjendet fëmija nën përkujdesje
- g. Nese ka pasur dëshmitarë me rastin e gjetjes së fëmiut merren edhe deklaratat e tyre

18.6. Gjithashtu procesverbal, përpilon edhe organi i kujdestarisë.

Pranimi i atësisë dhe/ose amësisë Neni 19

19.1. Personi i cili konsideron vetën baba/nënë të fëmiut mund të pranojë atësinë/amësinë në Zyrën e Gjendjes Civile ku ka lindur fëmiu dhe se deklarata e tij/saj duhet të regjistrohet në procesverbal. me nënshkrimin e tyre dhe të Zyrtarit të Gjendjes Civile duke e vënë vulën dhe datën në procesverbal.

19.2. Deklarata mbi pranimin e atësisë/amësisë shënohet në rubrikën “vërejtje” apo “regjistrimet e mëvonshme” duke cekur:

- a. Emrin personal të personit që ka pranuar atësinë/amësinë,
- b. Organin para të cilit është pranuar atësia/mëmsia,
- c. Numri dhe data e procesverbalit,
- d. Pajtimi i nënës për pranimin e atësisë të personit që konsideron baba,
- e. Organin para të cilit nëna e ka pranuar atësinë e atij personi,
- f. Data dhe numri i deklaratës.

19.3. Kur me rastin e pranimin të atësisë/amësisë ende nuk është caktuar emri personal i fëmiut në procesverbal ceket edhe ky fakt dhe regjistrohet në rubrikën “vërejtje” apo “regjistrimet e mëvonshme” se prindërit nuk ia kanë caktuar fëmiut emrin.

19.4. Atësia mund gjithashtu të njihet para Organit të Kujdestarisë , gjykatës apo organit tjetër ku ka lindur fëmiu të autorizuar për përgatitjen e dokumentëve publike. Këto organe janë të detyruara që pa vonesë të dërgojnë procesverbalin e vërtetuar tek Zyrtari i Gjendjes Civile kompetent i cili duhet të regjistrojë fëmiun në librin amzë të lindurve.

19.5. Atësia gjithashtu mund të njihet edhe me testament dhe këtë Zyrtari i Gjendjes Civile e evidenton në librin amzë të të lindurve.

19.6. Nëna e fëmiut të lindur jashtë martesës në paraqitjen e lindjes së fëmiut mund që me autorizimin e personit ta shënojë personin të cilin e konsideron at të fëmiut së vet dhe kjo deklaratë me gojë e prezentuar para Zyrtarit të Gjendjes Civile shënohet në procesverbal nga ai dhe pas regjistrimit të fëmiut edhe në rubrikën vërejtje shënon “nëna e fëmiut jashtëmartesor cakton babain e fëmiut”.

19.7. Nëse nëna në paraqitjen e lindjes së fëmiut nuk e ka shënuar personin që e konsideron at të fëmiut, Zyrtari i Gjendjes Civile do ta udhëzojë për të drejtën e saj që ta bëjë këtë gjë.

19.8. Kur e merr deklaratën e nënës për personalitetin e atit të fëmiut së saj, Zyrtari i Gjendjes Civile do ta ftojë personin e shënuar të deklarohet për atësinë e vet drejtpërdrejt para Zyrtarit të Gjendjes Civile ose në dokumentin e vërtetuar brenda afatit prej 30 ditësh. Letërthirja për personin e till medoemos i dorëzohet personalisht dhe sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia.

19.9. Nëse personi i ftuar deklaron se nuk do të jetë atë i fëmiut ose brenda afatit prej 30 ditësh nuk deklarohet për atësinë e fëmiut, Zyrtari i Gjendjes Civile lidhur me këtë gjë do ta informojë nënën e fëmiut.

19.10. Nëna e fëmiut me këtë rast mund të inicoj procedurën para gjykatës.

19.11. Nëse personi i ftuar deklaron në procesverbal para Zyrtarit të Gjendjes Civile se konsideron veten at të fëmiut dhe kjo është regjistruar në dokumentin e verifikuar nga organi kompetent Zyrtari i Gjendjes Civile zyrtarisht do ta regjistrojë si at të fëmiut, në librin amzë të të lindurve dhe për këtë regjistrimin duhet të informojë nënën e fëmiut dhe këtë fakt e evidenton edhe në rubrikën ”regjistrimet e mëvonshme”.

Martesa e lidhur mes prindërve të fëmiut pas pranimit të atësisë/amësisë Neni 20

20.1. Kur prindërit jashtëmartesor që kanë pranuar fëmiun si të vetin lidhin martesë, Zyrtari i Gjendjes Civile duke u mbështetur në librin amzë të të martuarve apo në bazë të certifikatës të lëshuar në bazë të këtij libri në rubrikën “vërejtje” apo “regjistrime të mëvonshme” shënon se:

- a. Me lidhjen e martesës fëmija është bërë martesor
- b. Vendi ku është lidhë martesa
- c. Numri vijues dhe data e regjistrimit të martesës në librin amzë

20.2. Poashtu edhe ndryshimet tjera si : vdekja apo shkorurzimi regjistrohen detyrimisht në rubrikën “vërejtje” apo regjistrime të mëvonshme “

20.3. Nëse gjatë martesës prindërit apo bashkshortët, të miturit i ndërrojnë emrin apo mbiemrin në rubrikën sipas nenit 17 të këtij ligji “regjistrimet e mëvonshme “ dhe në procesverbal Zyrtari i Gjendjes Civile do të shënojë se:

- a. Prindërit me marrëveshje i kanë caktuar emrin dhe/apo mbiemrin e ri fëmiut (cekjet emri dhe/apo mbiemri),

- b. Numri dhe data e procesverbalit dhe
- c. Organin para të cilit është dhënë deklarata

Regjistrimet e të dhënave me rastin e adoptimit

Neni 21

21.1. Me rastin kur prindërit janë të panjohur fëmija adoptohet në bazë të aktvendimit të organit kompetent, Zyrtari i Gjendjes Civile në librin amzë të të lindurve në rubriken për prindërit shënon emrin e adoptuesit me të dhënat përkatëse dhe në “regjistrimet e mëvonshme” do të shënoj:

- a. regjistrimi i të dhënave është bërë në bazë të aktvendimit të organit (cekët organi, numri dhe data e aktvendimit)

21.2. Me rastin e shkëputjes së adoptimit, i adoptuari që ka marrë mbiemrin e adoptuesit e merr mbiemrin e mëparshëm dhe kjo regjistrohet në rubrikën “regjistrimet e mëvonshme”.

Marrja e mbiemrit të mëparshëm pas shkororëzimit

Neni 22

Nëse njëri nga bashkshortët pas shkëputjes së martesës, shpalljes së saj joekzistuese, ose anulimit të saj e merr mbiemrin e mëparshëm që ka pasur para lidhjes së martesës, Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “regjistrime të mëvonshme” dhe në procesverbal cekë se:

- a. e ka marrë mbiemrin që ka pasur para lidhjes së martesës (duke cekur mbiemrin)
- b. numri dhe data e procesverbalit
- c. emri i organi para të cilit është dhënë deklarata.

Regjistrimi faktit të lindjes së qytetarëve të Kosovës jashtë vendit

Neni 23

23.1. Kur fakti i lindjes së fëmiut jashtë vendit prindërit e të cilit janë qytetarë të Kosovës dhe kur ata dëshirojnë ta regjistrojnë fëmiun e tyre edhe në Kosovë, ky fakt regjistrohet në komunën ku banojnë prindërit e fëmiut.

23.2. Ky fakt i lindjes së fëmiut jashtë Kosovës nga prindërit që janë banor të Kosovës regjistrohet në bazë të certifikatës së lindjes nga libri amzë i organit të shtetit ku ka ndodhur lindja dhe në rubrikën “vërejtje” shënohet “regjistrimi është kryer në bazë të certifikatës ndërkombëtare të lëshuar nga shteti” dhe shtohet:

- a. Emri i shtetit që ka lëshuar certifikatën
- b. Organi i atij shteti që ka lëshuar certifikatën
- c. Selia e organit
- d. Numri dhe data e certifikatës
- e. Vendi i lindjes
- f. Data e lindjes dhe adresa

23.3. Shënimet nga dokumenti i shtetit të huaj regjistrohen në librin e amzës ashtu siq janë të shënuara në dokument pa marrë parasysh alfabetin që është përdorur.

23.4. Kur Zyrtari i Gjendjes Civile është plotësisht i sigurt se si shqiptohet emri i një vendi apo shteti në gjuhën tone ai mund ta shënoj shqiptimin fonetik të atij vendi. Psh Östereich-Austria.

Libri Amzë i të Martuarve Neni 24

24.1. Në librin amzë të të martuarve regjistrohen faktet e lidhjes së martesave si bashkëjetesë ligjore e burrit dhe gruas.

24.2. Martesa duhet të regjistrohet në librin amzë të të martuarve të Zyrës Komonale të Gjendjes Civile aty ku njëri prej bashkëshortëve ka vendbanimin e përhershëm

24.3. Të drejtë martese përkatësisht të regjistrimit të faktit të lidhjes së martesës kanë personat madhor të moshës mbi 18 vjet.

24.4. Të drejtë në martesë përkatësisht në regjistrimin e martesës e kanë edhe personat jomadhor nëse paraprakisht këtë ka lejuar organi kompetent me aktvendim të veçantë.

24.5. Për të hyrë në martesë është e nevojshme që dy persona të gjinisë të kundërt, në prani të të tjerëve, të shprehin në mënyrë të lirë vullnetin dhe pajtimin e tyre për martesë përpara nëpunësit të gjendjes civile.

24.6. Deklarata duhet të jetë absolute dhe e menjëhershme.

24.7. Pjesëmarrës gjatë lidhjes së martesës janë nusja, dhëndëri, dy dëshmitarë dhe nëpunësi i gjendjes civile ndërsa të rastet e martesave me shtetas të huaj edhe përkthyesi.

24.8. Secili person me aftësi për të vepruar mund të jetë dëshmitar gjatë lidhjes së martesës.

24.9. Lidhja e martesës bëhet në Zyren e Gjendjes Civile në komunë në mënyrë solemne në ambiente të dedikuara për këtë qëllim.

24.10. Sipas kërkesës dhe dëshirës së bashkëshortëve lidhja e martesës bëhet edhe në ambiente tjera të preferuara nga ata.

24.11. Me rastin e lidhjes së martesës detyrimisht duhet të jen të pranishëm personat që lidhin martesë dhe dy dëshmitarët.

24.12. Martesat e lidhura për interes janë të ndaluara me ligj.

Kërkesa për lidhjen e martesës Neni 25

25.1. Personat që dëshirojnë të lidhin martesë duhet të paraqesin kërkesë pranë zyrtarit të gjendjes civile të kuvendit komunal.

25.2. Kërkesës për lidhjen e martesës duhet t'i bashkanëgjitet certifikata e lindjes, certifikata mbi gjendjen martesore dhe dokumente të tjera të parapara me akt të veçantë.

25.3. Zyrtari i gjendjes civile do të vendos mbi datën e lidhjes së martesës në marrëveshje me personat që dëshirojnë të lidhin martesën.

25.4. Pas parashtrimit të kërkesës për lidhjen e martesës, Zyrtari i Gjendjes Civile do t'u rekomadojë personave që dëshirojnë të lidhin martesë që deri në ditën e lidhjes së martesës, reciprokisht të informohen lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore, të vizitojnë konsulentin familiar për të siguruar mendimin përkitazi me zhvillimin e marrëdhënieve harmonike martesore dhe familjare, të njihen me mundësitë dhe përparësitë e planifikimit të familjes, si dhe të arrijnë pajtimin lidhur me mbiemrin e ardhshëm.

25.5. Qytetarët e Kosovës të cilët jetojnë një kohë të gjatë jashtë Kosovës, për lëshimin e certifikatës së statusit martesor duhet të kërkohej deklarata e dy dëshmitarëve të vërtetuar nga notari në vendin në të cilin jeton ai/ajo.

Detyrimet e Zyrtarit të Gjendjes Civile me rastin e lidhjes së martesës

Neni 26

26.1. Zyrtari i gjendjes civile nuk është i autorizuar të refuzojë pëlqimin e bashkëshortëve të ardhshëm, për të lidhur martesë përveç në rastet kur ekzistojnë pengesa martesore.

26.2. Zyrtari i Gjendjes Civile duhet me rastin e lidhjes së martesës të krijoj një ambient solemn dhe të qetë.

26.3. Lidhja e martesës fillon me raportin e paraqitur nga Zyrtari i Gjendjes Civile, duke treguar prezencën e bashkëshortëve të ardhshëm dhe dëshmitarëve dhe mosekzistimin e pengesave martesore të parapara me Ligj.

26.4. Mosekzistimi i pengesave të tilla konstatohet në bazë të dokumenteve të parashtruara, deklaratave të bashkëshortëve të ardhshëm, si dhe deklaratave të dëshmitarëve.

26.5. Në rast se zyrtari i gjendjes civile konstaton se nuk ekzistojnë pengesa për lidhjen e martesës, ai i informon bashkëshortët e ardhshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve në bazë të ligjit për të drejtën familjare.

26.6. Pas kësaj Zyrtari i Gjendjes Civile i pyet bashkëshortët e ardhshëm veç e veç nëse pajtohen për martesë me njëri-tjetrin.

26.7. Pasi t'i ketë siguruar deklaratat mbi pajtimin për hyrje në martesë, Zyrtari i Gjendjes Civile e shpall martesën të lidhur.

Shënimet me rastin e lidhjes së martesës në librin amzë

Neni 27

27.1. Në librin amzë për regjistrimin e martesës regjistrohen këto fakte për dhëndrin dhe nusën:

- a. Emri dhe mbiemri;
- b. Viti i lindjes;
- c. Numri personal;

- d. Deklarata për mbiemrin për të cilin janë përcaktuar bashkëshortët pas lidhjes së martesës;
- e. Data dhe vendi i lidhjes së martesës;
- f. Vendbanimi dhe adresa e të martuarve;
- g. adresa para lidhjes së martesës;
- h. emri dhe mbiemri i prindërve të dhëndërit dhe nusës;
- i. emri, mbiemri dhe adresa e dëshmitarëve dhe
- j. emri dhe mbiemri i personit zyrtar para të cilit lidhet martesë.

27.2. Gjithashtu si shënime plotësuese shënohen:

- a. zgjidhja e martesës
- b. vdekja e njërit bashkëshort
- c. shpallja e martesës e pa qenë

27.3. Nëse me rastin e lidhjes së martesës ka marrë pjesë edhe përkthyesi në rubrikën “vërejtje” shënohen edhe të dhënat e tij.

27.4. Me rastin e lidhjes së martesës bashkeshorti i cili është pajtuar që të ndërroj mbiemrin, Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “deklarata e bashkëshortit për ndërrim të mbiemrit” e shënon deklaratën e tij/saj.

27.5. Bashkëshorti i cili ka ndërruar mbiemrin regjistrimin e martesës e nënshkruan me mbiemrin e ri.

27.6. Zyrtari i Gjendjes Civile e regjistron lidhjen e martesës në librin amzë të të martuarve dhe në të njëjtin libër nënshkruhen bashkëshortët, dy dëshmitarët dhe Zyrtari i Gjendjes Civile.

27.7. Pas lidhjes së martesës, bashkëshortëve u lëshohet çertifikata nga Libri amzë i të martuarve.

Refuzimi për lidhjen e martesës nga ana e Zyrtarit të Gjendjes Civile Neni 28

28.1. Kur Zyrtari i Gjendjes Civile konstaton ekzistimin e çfarëdo pengese martesore, ai informon gojarisht parashtruesit e kërkesës se nuk mund të lidhin martesë dhe harton procesverbalin lidhur me çështjen.

28.2. Në procesverbal Zyrtari i Gjendjes Civile shënon:

- a. arsyen e refuzimit për lidhjen e martesës,
- b. pengesën për të cilën refuzohet lidhja e martesës
- c. personat për të cilët refuzohet lidhja e martesës
- d. data dhe vendi ku është kërkuar lidhja e martesës
- e. emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Gjendjes Civile që ka refuzuar lidhjen e martesës.

28.3. Nëse personat që kanë parashtruar kërkesën për lidhjen e martesës nuk pajtohen me refuzimin e zyrtarit të gjendjes civile, këta mund të iniciojnë procedurë gjyqësore para gjykatës kompetente lidhur me refuzimin e kërkesës për lidhjen e martesës.

28.4. Gjykata është e obliguar që të nxjerrë vendim në procedurë të shpejt brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

28.5. Kundër vendimit nga paragrafi 4 të këtij neni mund të parashtrohet ankesë brenda 8 ditësh nga dita e njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me moslejimin e martesës në organet e gjykatës së shkallës së dytë.

Lidhja e martesës me lejen e gjykatës Neni 29

Me rastin e lidhjes së martesës me lejen paraprake të gjykatës kompetente për tu liruar nga ndonjë pengesë martesore, Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “vërejtje” do të shënoj:

- a. Gjykatën që ka lejuar lidhjen e martesës,
- b. Selia e gjykatës që ka marrë vendim,
- c. Numri dhe data e vendimit,
- d. Për cilën pengesë është marrë vendimi nga ana e gjykatës,
- e. Emri i nusës dhe dhëndërit për të cilët është marrë vendimi.

Lidhja e martesës në shtetet e huaja Neni 30

30.1. Kur martesë është lidhur nga qytetarët tanë në shtetet e huaja dhe kur ajo martesë kërkohet të regjistrohet në librin amzë të martuarve, Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “vërejtje” shënon “regjistrimi është bërë me datë, në bazë të certifikatës së lëshuar nga libri amzë i të martuarve (ceket organi i shtetit të jashtëm që ka lëshuar certifikatën selia numri dhe data e saj) “kurse në rubrikën për “ vendin e lidhjes së martesës” shënohet: “vendi dhe shteti i lidhjes së martesës”

30.2. Emrat e shteteve të huaja shënohen ashtu siq janë të shënuar në dokument ose në pajtim me nenin 23.4.

E drejta e shtetasve të huaj për të lidhur martesë Neni 31

31.1. Personat me shtetësi të huaj kanë të drejtë të lidhin martesë para Zyrës Komonale të Gjendjes Civile të vendit.

31.2. Personat me shtetësi të huaj duhet të sjellin:

- - Certifikatën e lindjes;
- - certifikatën për aftësinë për të lidhur martesë (kapacitetin martesor) të ofruar nga autoritetet e vendit të tij e që dëshmon të drejtën e tyre për martesë sipas dispozitave të këtij ligji, se nuk ka ndalesa dhe pengesa për të lidhur martesë
- - certifikatën e vendbanimit dhe
- - dokumente të tjera të parapara me akte të veqanta.

31.3. Çertifikata bëhet e pavlefshme nëse martesë nuk lidhet gjashtë muaj pas lëshimit të certifikatës. Nëse çertifikata cakton afat më të shkurt kohor, ky afat do të aplikohet.

Regjistrimi i shkurorzimeve

Neni 32

32.1. Në rast të shkurorzimit, të shpalljës së martesës së paqenë, të zgjidhjes ose anulimit të martesës Zyrtari i Gjendjes Civile në librin amzë të martuarve në rubrikën “regjistrimet e mëvonshme” shënon “martesa është anuluar, zgjidhur, shkurorëzuar ose është shpallur e paqenë në bazë të aktvendimit të gjykatës duke cekur gjykatën numrin dhe datën e aktvendimit.”

32.2. Kur martesa shkëputet me rastin e vdekjes së njërit bashkshort Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “regjistrimet e mëvonshme” shënohen:

•“martesa është shkëputë me rastin e vdekjes së njërit bashkëshort” duke cekur datën dhe vendin e vdekjes, numrin dhe vitin e regjistrimit të vdekjes në librin e të vdekurve.

32.3. Regjistrimi i shkurorzimeve të qytetarëve tanë që kanë ndodhur në vendet e huaja njihet pasi të regjistrohet në gjykatën kompetente të vendit.

Libri amzë i të vdekurve

Paraqitja e faktit të vdekjes

Neni 33

33.1. Libër Amzë i të Vdekurëve është libri ku mbahen të gjitha shënimet lidhur me faktet e të gjitha vdekjeve të ndodhura.

33.2. Fakti i vdekjes regjistrohet në librin amzë së të vdekurve në bazë të paraqitjes me shkrim, ose në bazë të aktit të organit kompetent në vendin e vdekjes së të vdekurit.

33.3. Fakti i vdekjes paraqitet brenda 15 ditëve nga dita e vdekjes përkatësisht 21 ditë pasi është gjetur kufoma.

33.4. Fakti i vdekjes së qytetarëve të Kosovës të ndodhura jasht vendit paraqitet brenda afatit prej 60 ditëve.

33.5. Faktin e vdekjes duhet ta paraqesin anëtarët e familjes

33.6. Kur anëtarët e familjes nuk ekzistojnë, atë e paraqesin anëtarët e familjes më të gjerë, fqinjët ose kushdo që din për rastin e vdekjes.

33.7. Kur fakti i vdekjes ndodh në entet shëndetësore, hotele, konvikte, burgje, apo ente të tjera ato janë të obliguara për ta paraqitur faktin e vdekjes.

33.8. Personi i cili bën paraqitjen e faktit të vdekjes duhet të paraqes edhe vërtetimin e entit shëndetësor me të cilin vërtetohet vdekja.

33.9. Faktin e vdekjes zyrtari i gjendjes civile mund ta regjistroj edhe pa vërtetimin e entit mjeksor me dëshminë e dy dëshmitarëve të bërë para gjykatës, që kanë marrë pjesë në varrimin e të vdekurit apo kanë qenë dëshmitar në momentin e vdekjes së të vdekurit.

Paraqitja e faktit të vdekjes nga ana e organit kompetent
Neni 34

34.1. Kur fakti i vdekjes paraqitet nga organi kompetent dhe ai regjistrohet në librin amzë së të vdekurve Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën vërejtje “ do të shënoj:

- a. thirrja e organi që ka lëshuar dokumentin
- b. selia, vendi dhe
- c. numri data dhe vendi i vdekjes

34.2. Kur të dhënat e organit kompetent në dokument nuk janë të plota për tu regjistruar në librin e të vdekurve, Zyrtari i Gjendjes Civile do ta plotësoj me të dhënat tjera.

34.3. Kur fakti i vdekjes ndodhë jashtë vendit të banimit si pasoj e fatkeqësisë , në librin amzë së të vdekurve në rubrikën “vërejtje” shënohet

- a. Vendi i vdekjes,
- b. Koha e vdekjes

34.4. Kur fakti i vdekjes ndodh në automjetin e komunikacionit dhe kur vendi i vdekjes nuk dihet sakt Zyrtari i Gjendjes Civile në librin e të vdekurve shënon “ka vdekur në automjet dhe regjistrimi është bërë në vendin e varrimit.

34.5. Faktin e vdekjes në luftë apo nga fuqia madhore Zyrtari i Gjendjes Civile këtë fakt do ta regjistroj në bazë të akteve dhe vërtetimeve të organeve kompetente apo organizatave vendore apo ndërkombtare që kanë bërë evidentimin e tyre.

34.6. Kur fakti i vdekjes regjistrohet në bazë të aktvendimit të organit kompetent për shpalljen e personave të zhdukur si të vdekur Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën “vërejtje” shënon:

- a. Regjistrimi bëhet në bazë të aktvendimit të organit kompetent
- b. Thirrja e organit që ka marrë aktvendimin
- c. Data numri dhe vendi i marrjes së aktvendimit

Paraqitja e faktit të vdekjes në bazë të aktvendimit të gjykatës
Neni 35

35.1. Kur fakti i vdekjes regjistrohet në bazë të aktvendimit të gjykatës në bazë të ligjit mbi shpalljen e personave të zhdukur si të vdekur Zyrtari i Gjendjes Civile shënon :

- a. thirrja e gjykatës
- b. selia
- c. data dhe numri i aktvendimit

35.2. Kur aktvendimi për shpalljen e personave të zhdukur si të vdekur ndryshon në rubrikën “vërejtje” Zyrtari i Gjendjes Civile shënon: “aktvendimi i gjykatës për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur ndryshon” duke cekur:

- a. thirrjen e organit që ka ndryshuar aktvendimin
- b. selia
- c. data dhe numri i aktvendimit të regjistruar
- d. cilat janë ndryshimet e aktvendimit

35.3. Nëse gjykata e pezullon aktvendimin mbi shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur ky regjistrim i kryer më herët anulohet me vizë diagonale dhe në rubrikën “vërejtje” shënohet aktvendimi i pezulluar.

Fakti i gjetjes së kufomës së panjohur
Neni 36

36.1. Fakti i gjetjes së kufomes së panjohur regjistrohet në librin amzë dhe mbahet procesverballi.

36.2. Rubrikat për të dhënat e personit të cilit i është gjetur kufoma nuk plotësohen përpos në rubrikën “vërejtje” shënohet:

- a. Data, viti, vendi dhe koha e gjetjes së kufomës;
- b. moshja e përafërme;
- c. gjinia;
- d. gjatësia;
- e. ngjyra e flokëve dhe syve;
- f. vendi dhe data ku është varrosur;
- g. data dhe numri i procesverbalit;
- h. emrin e organit që ka mbajtur procesverbalin

36.3. Nëse identiteti i personit që i është gjetur kufoma vërtetohet më vonë ky fakt regjistrohet në rubrikën “regjistrime të mëvonshme” në bazë të aktvendimit të organit kompetent.

Të dhënat për regjistrimin e faktit të vdekjes
Neni 37

Në librin amzë së të vdekurve për faktin konkret të vdekjes shënohen këto të dhëna :

- a. Emri dhe mbiemri/dhe/ose mbiemri para martesës, së të vdekurit,
- b. Data muaji dhe viti i lindjes
- c. Data muaji, ora dhe vendi i vdekjes
- d. Gjendja martesore dhe gjinia
- e. Numri personal
- f. Shtetësia
- g. Vendbanimi dhe adresa
- h. Emri dhe mbiemri i prindërve
- i. Emri dhe mbiemri i personit përkatësisht institucionit që ka paraqitur vdekjen
- j. Natyrën dhe shkaqet e vdekjes
- k. Dhe shënime tjera relevante

Kreu III

Dispozitat e përbashkëta

Lëshimi i certifikatave Neni 38

- 38.1. Zyrtari i Gjendjes Civile sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të personit të interesuar lëshon certifikatë.
- 38.2. Certifikata lëshohet në bazë të kërkesës me shkrim nga i interesuari.
- 38.3. Kur ekziston infrastruktura elektronike kërkesa bëhet edhe në formë elektronike.
- 38.4. Certifikata përmban të gjitha shënimet e fundit në librin amzë deri në atë moment kur lëshohet.
- 38.5. Certifikata lëshohet si certifikatë e lindjes, martesës përkatësisht gjendjes martesore, vdekjes dhe të tjera.
- 38.6 Në certifikatë shënohen faktet përkatëse për të cilat lëshohet certifikata në bazë të shënimeve në librin amzë.
- 38.7. Në certifikatë nuk shkruhen shënimet mbi përmirësimet apo plotësimet e mëvonshme që janë bërë në librin amzë.(psh emri i adoptuesit të mëparshëm që tani nuk është adoptues i fëmiut).
- 38.8.Zyrtari i Gjendjes Civile me aktvendim refuzon të lëshoj certifikata vetëm në rast se konsideron se keqëpërdoret ajo.
- 38.9. Me rastin e lëshimit të certifikatës Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikat e paplotësuara do vëj vizë.
- 38.10. Në certifikatën e lindjes Zyrtari i Gjendjes Civile në rubrikën për prindërit do të shënoj të dhënat e atyre personave që janë të shënuar për prindër pa marrë parasyshtë bazën mbi të cilën janë caktuar prindërit e fëmiut.
- 38.11. Në certifikatën e lindjes nuk shënohet as rasti i gjetjes dhe kushtet e gjetjes së fëmiut.
- 38.12. Gjithashtu edhe në rast të adoptimit të fëmiut nuk shënohet kjo e dhënë dhe mbiemri i fëmiut shënohet ai mbiemër i marrë pas adoptimit.
- 38.13. Edhe në rastin e vazhdimit të drejtave prindërore apo të kujdestarit kjo e dhënë nuk shënohet në certifikatë.
- 38.14. Personit të martuar në momentin kur i lëshohet certifikata e lindjes në rubrikën për vrejtyje i shënohet data e lidhjes së martesës dhe mbiemri që ka pas martesës.
- 38.15. Personi që ka ndërruar emrin personal, në certifikatën e lindjes i shënohet emri të cilin e mban me rastin e lëshimit të certifikates ndërsa, sipas aktvendimit të organit kompetent në rubrikën vërejtje i shënohet edhe emri i mëparshëm.
- 38.16. Kur martesa është e zgjidhur në certifikatë shënohet edhe ky fakt.
- 38.17. Kur martesa është lidhur shumë herë, në certifikatë bëhet vetëm shënimi i martesës së fundit.

38.18.Në certifikatën e lindjes nuk shënohet ora e lindjes.

38.19.Të gjitha certifikatat e lëshuara duhet të nënshkruhen nga Zyrtari i Gjendjes Civile dhe të vulosen me vulë përkatëse.

38.20.Përmbajtja, forma, lloji e certifikatave, lloji i letrës siguroese të certifikatës rregullohen me akt të veçantë.

Ruajtja e librave të amzës dhe e shkresave Neni 39

39.1. Librat e amzës dhe shkresat në bazë të cilave është bërë regjistrimi duhet të sigurohen nga dëmtimi, asgjësimi dhe nga çdo keqpërdorim

39.2. Zyrtari i Gjendjes Civile është përgjegjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen gjatë përdorimit të librave amzë dhe shkresave përkatëse dhe ti vendos në mbështjellëse në arkivin amë.

39.3. Shkresat me vlerë të përhershme që janë përdorur me rastin e regjistrimit të fakteve konsiderohen të gjitha:

- a. procesverbalet
- b. fletëparaqitjet
- c. vendimet
- d. aktvendimet dhe
- e. shkresa të tjera

39.4. Për të gjitha shkresat mbahet arkiv i veçantë së bashku me librin e protokolit në bazë të fakteve përkatëse.

Përshkrimi (ripërtëritja) e librave amzë Neni 40

40.1. Kur me rastin e dëmtimit në mënyrë substanciale , asgjësimit apo zhdukjes së librit amzë duhet detyrimisht të bëhet përshkrimi nga kopja tjetër e librit.

40.2. Ekzemplari i përshkruar në faqen e parë do të ketë shënimin :

- a. Lloji i librit të asgjësuar apo të zhdukur që përshkruhet,
- b. Aktvendimin numrin, datën dhe organin kompetent që ka marrë atë për përshkrim të librit amzë,
- c. Vendi për të cilin mbahet libri dhe komuna,
- d. Faqet e përshkruara,
- e. Numri vijues dhe viti i regjistrimit,
- f. Nënshkrimi dhe vula e organit kompetent.

40.3.Në rast se janë zhdukur ose asgjësuar të dy kopjet e librit amzë ato shpallen në mjetet e informimit dhe ftohen qytetarët që ti paraqesin faktet e tyre për ripërtëritje të librit përkatës amzë.

40.4. Argumentimi i të dhënave në këtë rast bëhet sipas ligjit.

Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja

Neni 41

41.1. Zyrtarët e Gjendjes Civile në të njëjtën komunë respektivisht në territoret amë të së njëjtës komunë janë të obliguar që të bashkëpunojnë .

41.2. Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja bëhet sidomos në rastet e regjistrimeve pas afatit të paraparë, regjistrimeve të mëvonshme, nxjerrjes së aktvendimeve të ndryshme, përmirësimeve, plotësimeve, marrjen e aktvendimit për përtrirjen e librave amzë, ndihmës profesionale të ofiqarëve dhe mbikëqyrjes së punës së tyre, mbajtja e evidencës për lëndët në procedurë administrative.

41.3. Kjo mbikëqyrje dhe bashkëpunim lidhur me zbatimin e ligjit, bëhet edhe nga ana e organeve të ministrisë përkatëse.

41.4. Zyrtarët e Gjendjes Civile në komuna janë të obliguar që të përpilojnë raporte mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe raporte vjetore për të gjitha regjistrimet e kryera, në ministrinë përkatëse.

41.5. Kur mbikëqyrja dhe kontrollimi bëhet nga organet kompetente të ministrisë përkatëse Zyrtarët e Gjendjes Civile në komunë respektivisht në territorin amzë janë të obliguar që të ofrojnë të dhëna të kërkuara dhe pa pengesë të shikohen lëndet që kontrollohen.

41.6. Organet kompetente për mbikëqyrje dhe kontrollë përpilojnë raport përkatës dhe japin sygjerimet, vërejtjet dhe masat që duhet ndërmarrë në rastin konkret.

Përgjegjësitë e Zyrtarit të Gjendjes Civile

Neni 42

42.1. Zyrtari i Gjendjes Civile në librin amzë shënon vetëm ato të dhëna që i janë paraqitur përkatësisht përmban akti i organit kompetent

42.2. Regjistrimin në librin amzë Zyrtari i Gjendjes Civile është i obliguar ta kryej në mënyrë të rregullt dhe me efikasitet.

42.3. Kur ekziston dyshimi i bazuar për josaktësinë e të dhënave që i janë paraqitur Zyrtari i Gjendjes Civile për regjistrim është i detyruar që ti vërtetoj ato të dhëna.

42.4. Për çdo të dhënë të regjistruar në librin amzë Zyrtari i Gjendjes Civile është i detyruar që të lexoj para parashtruesit.

42.5. Moskryerja e obligimeve nga ana e Zyrtarit të Gjendjes Civile të parapara me këtë ligj përbën shkelje të rëndë të detyrës zyrtare.

Dispozitat ndëshkuese

Neni 43

43.1. Ministria përkatëse pas informimit nga neni 43 paragrafi 5 të këtij ligji mund të inicioj procedurë disiplinore sipas dispozitave për Shërbimin Civil.

43.2. Ndaj këtyre zyrtarëve mund të iniciohet procedura gjyqësore.

43.3. Prej 30 deri në 70 euro do të denohet me gjobë personi që:

- a. Zyrtari i Gjendjes Civile i cili nuk regjistron të dhënat mbi faktin e paraqitur në afatin e paraparë,
- b. Zyrtari i Gjendjes Civile kur nuk udhëheq në mënyrë të rregullt me librat amzë,
- c. Zyrtari i Gjendjes Civile i cili i zbulon të dhënat personave të paautorizuar.

43.4. Procedura për veprën penale fillon për :

- a. Zyrtarin i cili lëshon dokumente të falsifikuara.

Dispozitat përfundimtare Neni 44

44.1. Librat amzë përkatësisht formularët e tyre, certifikatat , përmbajtjen e tyre, llojet e certifikatave, formatin dhe llojin e letrës dhe ngjyrën speciale që do të përdoret për regjistrime rregullohet me ligjin për Gjendjen Civile.

44.2. Në bazë të formave të librave amzë dhe të dokumenteve që lëshohen në bazë të tyre, përgatiten vulat në pajtim me këtë ligj

44.3. Ministria përkatëse së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë do të hartojnë vërtetimin mbi vdekjen e personit në pajtim me këtë ligj.

44.4. Llojin dhe përmbajtjen e formularit të regjistrimit të librave të amzës e cakton organi kompetent sipas nenit 13.3 të këtij ligji

44.5. Librat amzë përkatësisht formularët e tyre ekzistuese vlejnë më së voni 3 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

44.6. Librat e rinjë amzë përkatësisht certifikatat në pajtim me këtë ligj dhe udhëzimet përkatëse administrative që do të nxirren do të përdoren prej në afatin e paraparë në paragrafin 5 të këtij neni.

44.7. Lidhur me formën e certifikatave dhe mënyrën e lëshimit të tyre sipas nenit 38.3 ministria për kryerjen e punëve në këtë fushë nxjerrë udhëzime përkatëse administrative.

44.8. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë të gjitha ligjet, rregulloret apo aktet tjera përkatëse me të cilat është punuar deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Hyrja në fuqi Neni 45

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP).

Ligji Nr.2004/46
27 shtator 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci